

V E N D I M

Nr.48, datë 28.1.1999

PËR KRIJIMIN E BORDIT TË HETIMIT TË AKSIDENTEVE DHE TË INCIDENTEVE AJRORE TË AVIACIONIT CIVIL

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 50 të ligjit nr.7877, datë 30.11.1994 “Për aviacionin civil shqiptar”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Objekt i këtij vendimi është hetimi i shkaqeve të aksidenteve e të incidenteve ajrore dhe parandalimi i tyre në të ardhmen.

2. Bordi i hetimit të aksidenteve dhe incidenteve ajrore të jetë me këtë përbërje:

- Drejtori i përgjithshëm i aviacionit civil kryetar
- Drejtori i drejtorisë së inspektoratit aeronautik i DPAC-së zëvendëskryetar
- Specialist nga drejtoria e inspektoratit aeronautik të DPAC-së anëtar
- Specialist nga drejtoria e trafikut ajror të DPAC-së anëtar
- Specialist nga drejtoria e standardeve teknike dhe sigurisë së DPAC-së anëtar

3. Në rastet e aksidenteve apo të incidenteve ajrore, civile, me dimension ushtarak, hetimi të realizohet në bashkëpunim me autoritetet përkatëse të Ministrisë së Mbrojtjes, në përputhje me rregullat e aviacionit civil.

4. Bordi i hetimit të aksidenteve dhe incidenteve ajrore të funksionojë i pavarur nga

pavarur nga çdo organ tjetër, interesi i të cilit mund të bjerë ndesh me detyrën që i është besuar bordit të hetimit.

5. Bordi i hetimit të aksidenteve dhe incidenteve ajrore, në bashkëpunim edhe me organet përkatëse hetimore, të ketë këto të drejta:

- të hyjë lirshëm në vendin e aksidentit apo incidentit, ku ndodhet avioni apo pjesë të tij;
- të sigurojë një listë të plotë të të gjitha provave, si dhe lëvizjen e kontrolluar të tyre, për qëllime ekzaminimi;
- liri të plotë në shfrytëzimin e përmbajtjes së dokumentacionit teknik dhe të fluturimit, si dhe të regjistruarve të fluturimit;
- mundësinë e marrjes së rezultateve të ekzaminimit të trupave të viktimave ose të testeve të bëra për këtë qëllim;
- mundësinë e marrjes së rezultateve nga ekzaminimet e personave, të përfshirë në operimet e avionit, ose të testeve, të bëra për këtë qëllim;
- mundësinë e marrjes së analizave laboratorike të karburantit, gazrave, lëngjeve të avionit etj.;
- të pyesë dëshmitarët;

- mundësinë e marrjes së çdo informacioni ose të dhëne që kanë pronari, operuesi apo prodhuesi i avionit, si dhe autoritetet e aviacionit civil.

6. Për realizimin e përgjegjësiave dhe të qëllimeve të ngarkuara e që kanë të bëjnë me grumbullimin, hetimin dhe ekzaminimin e të gjitha provave materiale, të gjithë institucionet shtetërore të mbështesin punën e bordit të hetimit, duke vënë në dispozicion të tij të gjitha mjetet e kërkuara, për realizimin e detyrave të përcaktuara në këtë vendim.

7. Çdo aksident ose incident ajror është subjekt i një hetimi të plotë, nga ana e bordit të hetimit.

Procedurat që duhen ndjekur, masat që duhen marrë dhe koha që nevojitet për realizimin e hetimeve të tilla, përcaktohen nga bordi i hetimit.

8. Kryetari i bordit të hetimit të aksidenteve dhe të incidenteve ajrore informon ministrin e Punëve Publike dhe Transportit për ecurinë e hetimeve të aksidentit apo të incidentit ajror.

9. Ministria e Rendit Publik, nëpërmjet organeve të veta, të marrë të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen e vendit të ngjarjes, duke zbatuar rregullat e përcaktuara për këtë qëllim.

10. Në rast nevojë mund të kërkohet asistencë apo ndihma në mjete, pajisje apo me ekspertë të hetimit, nga një shtet, anëtar të LICAOS, i cili nuk është përfshirë në aksident.

11. Çdo hetim, i kryer nga bordi i hetimit, shoqërohet me një raport të formuluar në formën e duhur, duke përcaktuar llojin dhe seriozitetin e aksidentit apo të incidentit ajror.

Ky raport deklaron qëllimin e hetimit, siç përcaktohet në pikën 1, dhe kur është e nevojshme, rekomandimet për veprimet, të cilat duhen ndërmarrë për sigurinë ajrore.

12. Konkluzionet e hetimit bëhen publike në raportin final të aksidentit apo të incidentit ajror në një kohë sa më të shkurtër, dhe, nëse është e mundur, brenda 12 muajve nga data e ndodhjes së aksidentit apo incidentit ajror.

Raporti final i dërgohet ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, si dhe të gjitha

institucioneve shtetërore, të interesuara.

13. Ministri i Punëve Publike dhe Transportit nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, u dërgon një kopje të raportit final të gjitha shteteve të interesuara, si dhe Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO).

14. Shpenzimet, për realizimin e hetimit të aksidenteve dhe incidenteve ajrore, mbulohen nga buxheti i shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko